



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

VENDIM


Nr 5 datë 05 / 04 / 2019

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR “PROMOVIMI I KULTURËS DHE TRASHËGIMISË KULTURORE TË QARKUT VLORE PËRMES METODAVE INOVATIVE”

Këshilli i Qarkut Vlorë në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi Relacionin dhe Projekt-Vendimin e paraqitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve, bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma b, neni 77, Ligji Nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.9936, datë 02.06.2008 “Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”

VENDOSI;

1. Miratimin e programit kulturor “*Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë kulturore të Qarkut Vlorë përmes metodave inovative*”,
2. Miratimin dhe zbatimin sipas ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe VKM 1173 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” për procedurën që do të ndiqet për realizimin e këtij programi
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut, Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78 pika 3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR “PROMOVIMI I KULTURËS DHE TRASHËGIMISË KULTURORE TË QARKUT VLORE PËRMES METODAVE INOVATIVE”

Të nderuar Këshilltarë!

Nisur nga rritja e fluksit turistik në vitet e fundit si dhe mungesa e një informacioni të përmbledhur mbi trashëgiminë kulturore në nivel qarku, vjen si domosdoshmëri krijimi i një portali promovues nëpërmjet metodave inovative . Kultura e një qyteti, bashkie ,rajoni ka një rol potencial në zhvillimin e rajoneve të vendit, duke kontribuar në punësim dhe mirëqënie, zhvillim të qëndrueshëm të qarqeve, etj. Kultura ,traditat e çdo bashkie dhe rajoni ndërthurin mjaft aktivitete, si shërbime të turistëve, kafe-restorante, njësi tregtare, qendra kulturore, pika turistike ,monumente kulture,etj.

Nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore, qarku ynë do të krijojë brandin e vet dhe do ta bëjë atë sa më unik. Ky brand do të promovohet me inteligjencë dhe me mjete inovative; me info që do të nxisin kureshtjen për zbulim të destinacioneve të panjohura të pasura me kulturë dhe traditë, do të ndërtojë marketim dhe promocion nëpërmjet anës digjitale në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Ne jetojmë në një qark që ka të gjithë potencialet e duhura për t'u kthyer në një destinacion turistik tërheqës për turistët, siç janë bukuritë natyrore, trashëgimia kulturore edhe mikpritja. Po kaq tërheqës qarku ynë është edhe për investitorët vendas edhe të huaj.

Zhvillimi i qarkut dhe gjithë vendit ndodhet në një fazë ridimensionimi. Masat që po merren aktualisht, synojnë ta shndërrojnë atë në një sektor konkurrues në rajon, përballë vendeve me traditë në këtë drejtim, siç janë Mali i Zi, Kroacia, Greqia, apo Italia.

Synimi kryesor është krijimi i një databaze digjitale e cila do të përfshijë në vetvete pikat arkeologjike, muzeumet, atraksionet turistike, zonat e rëndësishme së veçantë si edhe kuzhinën tradicionale dhe moderne të zonave të ndryshme në qark. Gjithashtu do të përfshihen dhe të dhënat mbi aksesin ndaj operatorëve që ofrojnë shërbime ndaj vizitorëve dhe turistave.